



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogcit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 020104-24052 dt. 22/05/2023

Në vështrim të nenit 13, dhe 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 nr. 320-19332 dt.07.04.2017 për Kushtet Kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, Rregullorja MF-NR04/2017 mbi kriteret, Standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, përmes thirrjes publike, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale për vitin 2023

- I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale për vitin 2023 janë:
 1. Lumturije Kiqina-Plakaj , DSHMS
 2. Kajtaz Kastrati DK
 3. Afrim Gllareva, DA
 4. Mehdi Ademi, Shoqëri Civile
 5. Kadire Tahirja, OJQ
 6. Jeton Prokshi, QPS- (anëtarë rezervë)
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale për kërkesat për subvencione përmes thirrjes publike për aplikim për vitin 2023, duke u bazuar në Rregullorën 12 nr. 320-19332 dt.07.04.2017 për Kushtet Kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullorja MF-NR04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e e Financimit Publik të OJQ-ve.
- III. Komisioni për vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale për vitin 2023 punën e tyre duhet ta kryejn me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.
- IV. Ky komision ka për obligim të shqyrtojë dhe vlerësojë të gjitha kërkesat pranë kësaj drejtorie në afatin kohor të përcaktuar me Rregullorën 12 nr. 320-19332 dt.07.04.2017 për Kushtet Kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve,

Rregullorën MF-NR04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e e Financimit Publik të OJQ-ve dhe në të njëjtën kohë të njoftoj me shkrim Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale lidhur me procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave /aplikacioneve të OJQ-ve.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- DSHMS-së;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Arkivit.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci